



ANALIZË E SHKURTËR POLITIKE, KOSOVË



Konrad
Adenauer
Stiftung

Zgjedhjet parlamentare në Kosovë 2014 Komuniteti serb karshi realiteteve të reja politike

Qershor 2014

www.kas.de/kosovo

Ivana Bozic

Milos Stanojkovic

Dina Milovanovic

Qendra për Angazhim Shoqëror

1. HYRJE

Ky dokument merret me diskutimin e trendeve dhe tendencave politike të komunitetit serb në Kosovë. Gjithashtu, vihen në pah dhe analizohen perceptimet dhe qëndrimet më dominuese të serbëve karshi proceseve aktuale në Kosovë dhe proceseve që po ndodhin mes Prishtinës dhe Beogradit. Merret parasysh realiteti politik në Kosovë që prej vitit 2008, në kontekstin e rolit mbikëqyrës të bashkësisë ndërkombëtare karshi institucioneve të Kosovës, si dhe të rolit ndërmjetësues të BE-së në bisedimet Beograd-Prishtinë. Në veçanti e njeh ndikimin e zyrtarëve të Beogradit, si një palë kyçe në proceset politike në Kosovë¹, posaçërisht në komunat në veri të lumit Ibër².

Rekomandimet në këtë dokument janë pikë referimi për zyrtarët në Prishtinë, dhe në Beograd, dhe po ashtu edhe për politikanët lokalë, sa i përket mënyrës se si do të sillen serbët në të ardhmen karshi proceseve të reja politike në Kosovë. Sqarimi me kohë i shqetësimeve kryesore të serbëve para zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2014, si dhe trajtimi si duhet i këtyre shqetësimeve pas zgjedhjeve, do të mund të kontribuonte në zgjidhjen e problemeve, në ndërtimin e besimit dhe në përmirësimin e marrëdhënieve mes politikanëve dhe komunitetit shqiptarë e serbë.

2.

Për më shumë se një dekadë, bashkësia ndërkombëtare³ e ka luajtur rolin kryesor në formësimin e sistemit qeverisës të Kosovës. Prej intervenimit ndërkombëtar (më 1999), shqiptarët janë angazhuar vazhdimisht në procesin e ndërtimit të shtetit dhe të institucioneve. Pas tërheqjes së detyruar të administratës serbe, serbët e Kosovës mbeten pa përkrahje politike, dhe si rrjedhojë kanë bërë lëvizje spontane dhe shpesh pa ndonjë drejtim të caktuar brenda realitetit të ri të krijuar që prej qershorit të vitit 1999. Në periudhën pas intervenimit në Kosovë, popullata serbe u përball me ndërrimin dhe

transformimin e marrëdhënieve të pushteteve. Në mungesë të udhëheqjes politike, kisha ortodokse serbe, përmes Këshillit Kombëtar Serb (KKS), me seli në Graçanicë, u shndërrua në faktorin kryesor për organizimin dhe udhëheqjen e komunitetit serb. Me vite të tëra tek serbët që kishin mbetur në Kosovë ekzistonin dilema, posaçërisht pas pavarësisë së Kosovës, nëse duhet të merrnin pjesë, ose jo, në sistemin politik të Kosovës.

Zgjedhjet lokale të 15 nëntorit të vitit 2009 ishin zgjedhjet e para që organizoheshin nga autoritetet e Kosovës pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008. Serbët i bojkotuan ato zgjedhje në katër komuna në veri të lumit Ibër, ku udhëheqësit lokalë u zgjodhën me votë të veçantë nën organizimin e Beogradit⁴. Përkundër presionit të madh⁵ nga Beogradi për t'i bojkotuar zgjedhjet e vitit 2009, një pjesë e komuniteti serb në jug të lumit Ibër (rreth 25 për qind) morën pjesë dhe e fituan pushtetin⁶ në disa prej komunave në të cilat serbët e përbënin shumicën⁷.

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare në dhjetor të vitit 2010 erdhën si rezultat i shpërbërjes së qeverisë në tetor të vitit 2010. Ndryshe prej thirrjeve të mëparshme të Beogradit që serbët t'i bojkotonin zgjedhjet në Kosovë, në vitin 2010 zyrtarët e Beogradit i drejtuan thirrjet vetëm kah serbët në veri. Në anën tjetër, partitë serbe shfaqën interes të madh në pjesëmarrjen e tyre në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2010, duke fituar ulëse për deputetë të zgjedhur me votë, dhe jo vetëm të emëruar për shkak të kuotës së vendeve të rezervuara⁸.

⁴ Formimi i institucioneve të veçanta lokale, të njohura si institucione paralele, që mbështeteshin prej Beogradit dhe kundërshtoheshin prej Prishtinës.

⁵ Politikanë nga Partia Radikale Serbe madje përdorën edhe kërcënime dhe kërkuan që të dënohej secili serb që realizonte të ardhura nga qeveria e Beogradit, dhe i cili do të merrte pjesë në zgjedhje. Burimi: "Serbët duhet t'i bojkotojnë zgjedhjet në Kosovë", B92, 30 tetor 2009, burimi i informacionit i vizituar më 20 prill 2014.

⁶ Krijimi i institucioneve të tjera lokale që mbështeteshin prej Prishtinës, por kundërshtoheshin prej Beogradit.

⁷ "Zgjedhjet në Kosovë: test i pjekurisë," Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi, nëntor 2009, nr. 46

⁸ Sipas nenit 64 të Kushtetutës së Kosovës: Kuvendi i ka njëqind e njëzetë (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura. Vendet në kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre në zgjedhjet për Kuvend. Krahës

¹ Për shembull, zyrtarët serbë kërkonin që të hiqej logoja e Kosovës prej fletëvotimeve të nëntorit në pjesën veriore të Kosovës, dhe qeveria e Kosovës e miratoi këtë kërkesë.

² Veriu i Kosovës i përfshinë katër komuna: Leposaviqin, Zveçanin, Zubin Potokun dhe Mitrovicën. Lumi Ibër e ndan Mitrovicën mes pjesës jugore të banuar me shumicë shqiptare dhe pjesës veriore të dominuar me serbë.

³ Me termin bashkësi ndërkombëtare i referohemi OKB-së dhe agjencive të ndryshme të saj, BE-së, NATO-s, OSBE-së, dhe Zyrës Civile Ndërkombëtare (ICO).

Rëndësia e numrit të vendeve që mbahen prej përfaqësuesve serbë në Kuvend kuptohet më së miri përmes kompetencave të Kuvendit. Për shembull, për ta ndryshuar kushtetutën, Kuvendi duhet t'i ketë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve, duke përfshirë edhe dy të tretat (2/3) e të gjithë deputeteve me ulëse të rezervuara dhe të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë⁹. Për më tepër, legjislacioni i rëndësisë së veçantë varet gjithashtu në votën e shumicës së deputetëve dhe të deputetëve të komuniteteve që nuk janë shumicë¹⁰. Kjo do të thotë se nuk mund të bëhet asnjë ndryshim i kushtetutës, apo miratim i legjislacionit me rëndësi të veçantë, pa pajtimin e komunitetit serb (pasi e kanë gjysmën (1/2) e përfaqësuesve të pakicave). Në anën tjetër, miratimi i ligjeve, vendimeve dhe akteve të tjera kërkon votën e shumicës së përfaqësuesve të Kuvendit¹¹ që do të thotë se ndikimi i votës së komunitetit pakicë varet drejtpërdrejtë prej numrit të përgjithshëm të vendeve të tyre në Kuvend.

Në kontekstin e normalizimit të marrëdhënieve Beograd-Prishtinë, zgjedhjet lokale të mbajtura në komunat me shumicë serbe më 3 nëntor dhe 1 dhjetor të vitit 2013 ishin me rëndësi të madhe pasi për herë të parë po organizoheshin në kuadër të ligjeve të Kosovës

këtyre, kushtetuta i garanton njëzetë (20) prej njëqind e njëzet (120) vendeve për përfaqësuesit e grupeve pakicë. Dhjetë (10) prej këtyre njëzetë (20) janë të rezervuara për përfaqësuesit e komunitetit serbë në Kosovë: partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin serbë në Kosovë, do të kenë numrin e vendeve në Kuvend të fituar në zgjedhjet e hapura, me minimumin dhjetë (10) vende të garantuara, në rast se numri i vendeve të fituara është më i vogël se dhjetë (10). Kjo nënkupton se cilido që të jetë rezultati i votimit, komuniteti serb do t'i ketë dhjetë (10) vende në Kuvend, ndërsa e gjitha mbi këtë numër varet prej rezultati të votimit.

⁹ Shih: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 65

¹⁰ Legjislacioni i rëndësisë së veçantë:

(1) Ligjet që i ndryshojnë kufijtë komunalë, themelimi ose shpërbërja e komunave, përkufizimi i pushteteve të komunave dhe pjesëmarrja e tyre në marrëdhëniet ndër-komunale dhe me gjerë;
(2) Ligjet për realizimin e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre, përveç atyre që janë të përcaktuara me kushtetutë;
(3) Ligjet për përdorimin e gjuhës;
(4) Ligjet për zgjedhjet lokale;
(5) Ligjet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;
(6) Ligjet për liritë fetare ose marrëveshjet me bashkësitë fetare.

¹¹ Ligjet, vendimet dhe aktet e tjera që janë miratuar nga Kuvendi me votën e shumicës së deputetëve të pranishëm dhe që kanë votuar, përveç nëse thuhet ndryshe në kushtetutë.

në pjesën veriore të territorit. Në kuadër të marrëveshjes së Brukselit, serbët në veri të lumit Ibër morën pjesë për herë të parë në zgjedhje, natyrisht, me bekimin e Beogradit. Përkundër thirrjeve të Beogradit që serbët të dalin në numër të madh në votime, procesi i votimit u pezullua në pjesën veriore të Mitrovicës më 3 nëntor 2013¹². Dalja me e lartë në të tri komunat e tjera serbe në veri ishte 22%, por Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Kosovës i pranoi rezultatet dhe e kufizoi rivotimin vetëm në pjesën veriore të Mitrovicës. Zyrtarët në Beograd i ftuan serbët që të rivotojnë, madje edhe përmes përdorimit të kërcënimeve politike si bojkotimi që do të thoshte që shqiptarët do ta udhëhiqnin qytetin, dhe se Serbia nuk do të mund ta formonte administratën aty. Është e qartë se përsëritja e mëtejme e akteve të izoluara të dhunës në veri do ta pengonte krijimin e asociacionit të komunave. Andaj, përkeqësimi i situatës do të shmangej nëse qeveria e Serbisë, politikanët lokalë dhe zyrtarët e Prishtinës do të jepnin sqarime se çfarë dobie do të sillte zbatimi i marrëveshjes, dhe nëse do të vepronin me vendosmëri kundër atyre që planifikojnë të ushtrojnë rezistencë të dhunshme. Deklaratat kundërthënëse sa i përket marrëveshjes kontribuojnë edhe me shumë në krijimin e një situatë të pështjelltë, ku disa thonë se marrëveshja shënon fundin e institucioneve serbe në Kosovë, e të tjerët pretendojnë se marrëveshja do ta fuqizonte edhe më tej praninë serbe në Kosovë. Kjo situatë është e kuptueshme, kur kihet parasysh që për katërmbëdhjetë vjet serbëve iu kishte thënë se veriu është pjesë e Serbisë, dhe tani, sipas marrëveshjes së Brukselit, serbët duhet të integroheshin në sistemin juridik dhe institucional të një shteti të cilin nuk e njohin.

Rrjedhimisht, duhet të zhvillohet dialogu mes kryetarëve serbë lokalë dhe autoriteteve qendrore në Prishtinë e Beograd me qëllim që t'u ofrohet mbështetje udhëheqësve lokalë lidhur me zbatimin e politikave lokale si dhe me funksionimin e administratës publike. Kjo vjen e bëhet edhe më e rëndësishme kur kemi parasysh se administrata lokale në veri ka një legjitimitet të dobët për shkak të daljes së ulët në zgjedhje. Dialogu do t'ju mundësonte autoriteteve në Beograd dhe Prishtinë të njihen më mirë me problemet e përditshme të serbëve, si dhe me vështirësitë e zbatimit të marrëveshjes së Brukselit. Institucionet e Kosovës dhe ato ndërkombëtare, në

¹² Grupet radikale dhe ekstremiste u futën në tri qendra të votimit dhe i shkatërruan kutitë e votimit si dhe i kërcënuan ata që donin të votonin.

bashkëpunim me autoritetet lokale, duhet t'u dërgojnë mesazh të qartë të gjithë atyre që kanë për qëllim pengimin e procesit, si dhe duhet të jenë më të vendosur për ta fuqizuar sundimin e ligjit. Kjo do t'i inkurajonte serbët që të marrin pjesë më shumë në jetën publike të Kosovës dhe ta krijojnë besimin qytetar mes qytetarëve dhe institucioneve.

Me 8 qershor, serbët në veri të lumit Ibër do të tërhiqen drejt një skene edhe më të madhe politike në Kosovë. Zyrtarët e Beogradit kanë deklaruar hapur se serbët duhet të marrin pjesë në zgjedhjet parlamentare, dhe se duhet të dalin në numër të madh, me pretendimin se një gjë e tillë do ta forconte edhe me tej ndikimin e Serbisë në Kosovë. Beogradi i ka bashkuar politikanët nga jugu dhe veriu i lumit Ibër në një listë të quajtur Srpska List (Lista Serbe), e cila i ka bërë bashkë ata që ishin kundërshtarët më të mëdhenj mes vete për katërmbëdhjetë vjet më radhë. Lista Serbe i bashkon si serbët nga "institucionet paralele", ose thënë ndryshe ata që e kundërshtojnë shtetësinë e Kosovës, ashtu dhe ata që kanë marrë pjesë më herët në institucione dhe që janë etiketuar si tradhtarë ose serbët e Thaçit.

Kandidatët në Listën Serbe konsiderojnë se çështjet e rëndësishme së veçantë për komunitetin serb do të trajtoheshin si duhet vetëm nëse veprojnë të bashkuar dhe nëse konsolidohen mes vete. Politikanët serbë, të cilët nuk janë në atë listë, e shohin atë si një platformë të paqëndrueshme politike që do të zgjasë deri në sesionin e parë parlamentar, ose e shohin si një "dorë të zgjatur" të Beogradit që mund t'i udhëzojë deputetët e ardhshëm në marrjen e vendimeve. Përveç kësaj, diskursi publik në Kosovës e ka ngritur çështjen e pengimit të mundshëm dhe të ngadalësimit të funksionimit të institucioneve nëse Lista serbe do të bëhej pjesë e koalicionit të ardhshëm qeverisës. Si do që të jetë, dhe pa marrë parasysh se cila listë do të ketë më shumë kandidatë në parlament, është më se e qartë se me një dalje të lartë, dhe si rrjedhojë me vende të mjaftueshme në Kuvend, serbët mund ta shtojnë dukshëm ndikimin e tyre në qeverinë e Kosovës.

3.

Trajtimi i disa prej shqetësimeve kryesore të serbëve të Kosovës

"Marrëveshja e parë mbi parimet që qeverisin normalizimin e marrëdhënieve", e cila njihet edhe si Marrëveshja e Brukselit, shënoi ndërrimin e kursit të

politikës së qeverisë së Serbisë që prej vitit 1999. Beogradi kishte refuzuar që të negocionte drejtpërdrejtë me institucionet e Kosovës, dhe se bashkëbiseduesi kryesor për ta ishte bashkësia ndërkombëtare. Pas trazirave të dhunshme në vitin 2004, Beogradi u bëri thirrje serbëve të Kosovës që t'i bojkotonin institucionet e Kosovës. Situata u përkeqësua edhe më tej pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, kur Beogradi e ashpërsoi komunikimin me Prishtinën. Andaj, marrëveshja e Brukselit është një hap tejte i rëndësishëm në marrëdhëniet midis Beogradit dhe Prishtinës. Shumë thonë se kjo erdhi si rezultat i interesit të Serbisë për t'u integruar në Bashkimin Evropian, për të cilën përmirësimi i marrëdhënieve me Kosovës doli të jetë një prej kushteve kryesore. Në anën tjetër, Prishtina e pranoi marrëveshjen, posaçërisht lidhur me formimin e asociacionit/bashkësisë së komunave me shumicë serbe, vetëm pas një presioni të madh ndërkombëtar. Edhe pse bashkësia ndërkombëtare beson se marrëveshja do të zbatohet, ka sosh që janë të shqetësuar lidhur me rezistencën e dhunshme ndaj zbatimit të saj, e që mund të vinte prej elementeve ekstremiste në veri. Po ashtu, dykuptimësitë që i ka marrëveshja lënë hapësirë për interpretime nga më të ndryshme, si pretendimet që do të sjellë integrim të pjesshëm apo ndarje të plotë institucionale të komunitetit serb. Këto referenca bazohen në ndarjen aktuale të komunitetit serb në veri dhe të rezistencës së mundshme të dhunshme lidhur me zbatimin e plotë nga një pjesë e tyre. Për serbët në jug të Ibrit, marrëveshja nënkupton, në përgjithësi, ndarje mes tyre dhe serbëve në veri, dhe në këtë kuptim ndjehen pjesërisht të diskriminuar dhe të lënë pas dore. Serbët në veri trajtohen ndryshe, me politika të ndryshme, dhe një qasje e tillë vetëm sa do t'i largojë ata, përderisa përpiqen që të trajtohen si një komunitet i vetëm. Kur kemi parasysh zbatimin e marrëveshjes së Brukselit, ajo të cilës i referohen palët e interesit më së shumti është të qenit në dijeni për pengesat në terren. Pengesat mund të jenë edhe mekanizmat e zbatimit të cilët nuk janë zhvilluar sa duhet, si fjala vjen mungesa e personelit të trajnuar, këshilltarëve ligjorë, zyrtarëve publikë, etj. Zbatimi i marrëveshjes kërkon dhe duhet të jetë një proces gjithëpërfshirës dhe afatgjatë, dhe që mund të zgjatë për vite të tëra.

Situata në veri është e brishtë dhe e tensionuar, andaj serbët janë të hutuar nga efektet dhe ndryshimet e mundshëm që mund të sjellë zbatimi i marrëveshjes së Brukselit. Ata janë të shqetësuar se përfundimi i pranisë së drejtpërdrejtë të institucioneve të Beogradit,

dhe të pagave për serbët, do të ndikojë në zvogëlim të vendeve të punës, në pensione, në kujdes shëndetësor, dhe në arsim¹³. Integrimi në institucionet e Kosovës nënkupton po ashtu paga më të vogla. Për më tepër, rritja e rolit të Prishtinës përbën gjithashtu shqetësim për disa prej tyre, duke e pasur parasysh mungesën e besimit në institucionet e Kosovës.

Një tjetër brengë e serbëve ka të bëjë me vet mosbesimin e tyre në udhëheqësit lokalë serbë, duke e vënë në dyshim fuqinë e tyre politike dhe aftësinë për të marrë vendime. Përveç kësaj, ata që kanë marrë pjesë në institucionet e Kosovës janë karakterizuar shpesh në publik nga zyrtarët e Beogradit si serbët e Thaçit.¹⁴ Duket qartë se serbët e Kosovës kanë nevojë për vendimmarrës lokalë që janë të aftë për të hartuar strategji dhe programe pragmatike, të cilat janë të përshtatshme për rrethanat në terren. Për më tepër, këta vendimmarrës lokalë duhet ta kenë vullnetin që të sigurojnë qëndrueshmëri të programeve të tilla. Roli i bashkësisë ndërkombëtare mund të jetë tejet i rëndësishëm në mbështetjen dhe monitorimin e këtyre programeve, në ofrimin e trajnimeve dhe të këshillave për vendorët, dhe në inkurajimin e ndërmarrjes së iniciativave në nivel lokal. Në aspektin politik, udhëheqësit serbë duhet të pavarësohen gradualisht nga Beogradi, dhe të krijojnë institucione lokale të qëndrueshme dhe të afta për t'i zgjidhur vet problemet me Prishtinën. Theksi duhet të vihet në mbështetjen e udhëheqësve të rinj, të cilët nuk kanë të kaluar kriminale, dhe me mbështetje të qartë nga bashkësia ndërkombëtare.

Në kontekstin e dinamikave të marrëdhënieve ndëretnike, duket se mungesa e besimit është e evidente në vlerësimin e veprimeve të grupit tjetër etnik. Kjo

vërehet qartë në veri, e posaçërisht në pjesën veriore të Mitrovicës. Edhe pse krimi i organizuar mbizotëron në veri¹⁵, ka tendenca nga të dy komunitetet që t'u japin ngjyrimë politike të gjitha incidentet dhe krimeve që ndodhin atje. Forcimi i lirisë së medias dhe të gazetarisë hulumtuese do t'i mundësonte të dy komuniteteve që të kenë burime të ndryshme dhe alternative të informatave, madje edhe krijimin e mundësive për aktivitete të përbashkëta mediatike. Përveç kësaj, udhëheqësit politikë të të dy komuniteteve duhet ta inkurajojnë sektorin e biznesit që të krijojnë mundësi të punësimit për pjesëtarët jo shumicë, duke krijuar politika për vende të punës për pjesëtarët e komuniteteve të ndryshme.

Një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet ekzistimit të disa grupeve lokale dhe individëve me ndikim në pjesën veriore. Ata kanë ndikim të madh në mobilizimin e serbëve, duke i frikësuar dhe kërcënuar ata që e kanë vullnetin për t'u angazhuar në kuadër të kornizës politike të Kosovës¹⁶. Shfrytëzimi i situatës së brishtë dhe të tensionuar nga ekstremistët do të mund të kontribuonte në ruajtjen e tregut të zi në veri. Duke e pasur parasysh faktin se ekzistojnë edhe grupe jo formale të sigurisë, të cilat mund të përpiqen që të krijojnë probleme, dhe të cilat sipas marrëveshjes duhet të shpërbëheshin, atëherë KFOR-i dhe misioni i EULEX-it, si faktorë kryesorë të sigurisë të paraparë edhe në marrëveshje, duhet të qëndrojnë në terren pasi që serbët shfaqin mungesë besimi në Policinë e Kosovës (KP) dhe në institucionet e tjera të sistemit të sigurisë së Kosovës¹⁷. Në korrik të vitit 2013, Prishtina

¹³ Një vlerësim i thjeshtë tregon se rreth 85% e të gjitha të ardhurave në veri varen nga sektori publik, rreth tri të katërtat e të cilave vijnë nga Serbia, dhe një e katërta nga Kosova. Përmbyllja e planifikuar e institucioneve të financuara nga Serbia dhe ri-integrimi i tyre në kuadër të ligjeve të Kosovës do të rezultojë në paga dukshëm më të vogla si dhe në më pak vende pune (për shembull në administratën lokale dhe spitale). Burimi: Filip Ejdos, Leon Malazogu dhe Milan Nic, "Municipal elections in Northern Kosovo: Towards a new balance?", Central European Policy Institute, 10 tetor 2013, ky burim është vizituar më 23 prill 2014, <http://www.cepolicy.org/publications/municipal-elections-northern-kosovo-toëards-neë-balance>

¹⁴ Petkovic, "Dacic zapretio liderima Severa," Vesti online, 25 maj 2013, ky burim është vizituar më 23 prill 2014, <http://www.vesti-online.com/Vesti/Srbija/315462/Dacic-zapretio-liderima-Severa>

¹⁵ "Kosovo 2013 Crime and Safety Report," The Overseas Security Advisory Council (OSAC) – Bureau of Diplomatic Security, U.S. Department of State, Report, 2 shkurt 2012, ky burim është vizituar më 19 prill 2014, <https://www.osac.gov/pages/contentreportdetails.aspx?cid=12089>

¹⁶ Ekipi i BIRN, "Hardliners Threaten North Kosovo Serbs at Polls." Balkan Insight, 3 nëntor 2013, ky burim është vizituar më 19 prill 2014, <http://www.balkaninsight.com/en/article/hardliners-threaten-north-kosovo-serbs-at-polls>

¹⁷ Korrik 2011, pas vendimit të autoriteteve të Kosovës për dërgimin e trupave të Njësisë Speciale të Policisë së Kosovës (ROSU) për zbatimin me forcë të politikave doganore në kufijtë në veri me Serbinë, serbët lokalë e bllokuan urën kryesore mbi lumin Ibër. Tërheqja e shpejtë e policisë ROSU nga veriu e demonstroi jo vetëm aftësinë e serbëve në veri për të bërë rezistencë, por i shfaqti edhe kapacitetet e kufizuara të Prishtinës për t'i zgjidhur kontestet me forcë.

u pajtua që të bëjë një amnisti¹⁸ për serbët në veri me synim që të mundësojë, apo ta ndihmojë integrimin e serbëve, duke ofruar siguri se ata nuk do të persekutoheshin për shkak të rezistencës që i kishin bërë autoriteteve të Kosovës në të kaluarën, dhe e cila do të përbënte pengesë për marrjen e roleve dhe përgjegjësi në institucionet publike të Kosovës në të ardhmen. Institucionet e Kosovës, me përkrahjen e bashkësisë ndërkombëtare, duhet ta krijojnë, ta hartojnë dhe ta zbatojnë një strategji gjithëpërfshirëse që do të merrej me të kaluarën, krahas drejtësisë kalimtare të bazuar në respektin ndaj të gjitha viktimave, si dhe me persekutimin juridik të bazuar në përgjegjësi individuale, me qëllim që të fillohet me procesin e ri-pajtitimit ndëretnik në Kosovë.

Në përgjithësi shqetësimet e serbëve lidhen me mungesën e sigurisë njerëzore¹⁹ që kontribuon në ndjenjën e pasigurisë së tyre për të ardhmen në Kosovë. Në mesin e gjërave që ka pak mundësi të ndodhin janë edhe supozimet se zbatimi i marrëveshjes do të çonte në një eksod²⁰ të heshtur të popullatës serbe apo në një asimilim të tyre. Disa serbë në veri e barazojnë marrjen e shtetësisë dhe të dokumenteve të Kosovës me asimilimin e tyre në shqiptarë. Edhe pse serbët në veri, me gjasë, do të duhet të veprojnë sipas kornizës politike të Kosovës, marrëveshja u ofron siguri të mjaftueshme për marrjen në duar të udhëheqjes së punëve të tyre, si formimi i një asociacioni të komunave, polici lokale autonome, dhe garanci që Forcat e Sigurisë së Kosovës dhe njësitë speciale të policisë nuk do të hynin në veri pa pëlqimin e kësaj të fundit. Për t'i marrë parasysh dhe për t'i sqaruar problemet e popullsisë serbe, duhet të ketë më shumë transparencë mes qeverisë së Serbisë dhe serbëve në Kosovë. Zyrtarët e Prishtinës duhet ta mbajnë një

qëndrim të qartë, dhe të krijojnë kanale komunikimi më të shpeshta me komunitetin serb, posaçërisht në veri, pasi dykuptimësia e marrëveshjes së Brukselit, dhe politika serbe deri më tash karshi Kosovës, kontribuon në njëfarë ndjenje të çorientimit dhe të hutimit tek komuniteti serb. Paraqitja e qartë e asaj se çka nënkupton në praktikë zbatimi i marrëveshjes, duke iu shmangur interpretimeve arbitrare që kontribuojnë në polarizimin e shoqërisë, është mase e nevojshme për të dy anët e lumit Ibër.

Ka edhe probleme të tjera të mëdha, por proceset e fundit politike mes Beogradit dhe Prishtinës ua hapin rrugën serbëve të Kosovës që të marrin pjesë dhe të dalin në masë të madhe në zgjedhjet parlamentare të vitit 2014, duke i zgjedhur përfaqësuesit më legjitim të serbëve të Kosovës në Parlamentin e Kosovës. Zgjidhja e problemeve në veri do t'u mundësonte përfundimisht institucioneve të Kosovës që të merren me probleme të tjera madhore të shoqërisë kosovare, si zvogëlimi i shkallës së papunësisë, luftimi i vazhdueshëm i korrupsionit, i krimit të organizuar dhe shumë problemeve të tjera.

¹⁸ Kuvendi i Kosovës e ka miratuar ligjin për amnisti, i cili ishte obligim i marrëveshjes së Brukselit. Gjatë debatit parlamentar për projektligjin e amnistisë, me qindra përkrahës të Lëvizjes Vetëvendosje mbanin protesta jashtë ndërtesës së Kuvendit. Ligji u përball po ashtu me një rezistencë që vinte nga nivelet prej poshtë-lartë. OJQ-të mbajtën protesta paqësore që kërkonin që një legjislacion i tillë duhej ta amnistonte pjesën veriore të Kosovës, por sundimi i ligjit të mbetej i pandryshuar në pjesën tjetër të territorit.

¹⁹ Siguria njerëzore përkufizohet në mënyrë specifike këtu si liria prej frikës.

²⁰ Filip Ejdu, Leon Malazogu dhe Milan Nic, "Municipal elections in Northern Kosovo: Towards a new balance?", Central European Policy Institute, 10 tetor 2013, ky burim është vizituar më 23 prill 2014, <http://www.cepolicy.org/publications/municipal-elections-northern-kosovo-towards-new-balance>

**Për autorët:**

Milosh Stanojkovic ka diplomuar nga Universiteti Juridik i Nishit, Departamenti i Drejtësisë Penale. Në shtator të vitit 2013, Milloshi ka punuar si menaxher i projektit Vizioni i zhvillimit lokal i komunitetit serb në Kosovë. Gjatë studimeve ishte anëtar aktiv i asociacionit të studentëve si dhe anëtarë i parlamentit të Fakultetit dhe i parlamentit të Universitetit. Përveç kësaj, Milloshi ka shërbyer si vullnetar në disa zyra të avokatëve, dhe ka vazhduar të bëjë punë vullnetare edhe pas diplomimit deri në korrik të vitit 2012.

Ivana Bozic ka diplomuar prej Universitetit të Beogradit, në Fakultetin e Shkencave Politike, Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Magjistratura e Ivanës në kuadër të studimeve të konflikteve në Universitetin Singidunum është me titullin "Analizë e pajtimit ndëretnik në Kosovë". Ajo ka ndihmuar në zbatimin e tri projekteve që kishin të bënin me marrëdhëniet mes Serbisë dhe Kosovës, të realizuara nga Forumi për Marrëdhënie Etnike. Ivana ishte një prej hulumtueseve dhe bashkautorëve të studimit të fizibilitetit për arsimin e lartë në komunat e Preshevës dhe të Bujanovcit.

Dina Milovanovic e mban titullin e baçelorit në etnologji dhe antropologji, Universiteti i Beogradit, dhe aktualisht është duke punuar në magjistraturën e saj që ka të bëjë me antropologjinë e ekonomisë. Dina ka punuar si hulumtuese në Forumin për Marrëdhënie Etnike, ku ka pasur mundësinë të merr pjesë në një varg projektesh dhe ngjarjesh me fokus marrëdhëniet e Serbisë dhe Kosovës. Vitin e tretë të studimeve themelore e ka kaluar në Universitetin e Minesotës – "Twin Cities", përmes bursës FORECAST (tani Global UGRAD). Fushat e interesit të saj të veçantë janë ekonomia, ndihma e jashtme, periudha pas socializmit, politikat publike, arsimi, antropologjia e aplikuar.

Informata rreth Qendrës për Angazhim Shoqëror

Qendra për Angazhim Shoqëror është një organizatë jo qeveritare, jo fitimprurëse dhe jo politike me qendër në Prishtinë, Kosovë. Financohet dhe udhëhiqet prej ekspertëve të rinj që përpiqen t'i promovojnë marrëdhëniet ndëretnike dhe normalizimin e jetës politike dhe shoqërore në Kosovë dhe në tërë Ballkanin perëndimor. Misioni i tyre ka të bëjë me promovimin e tolerancës dhe të bashkëpunimit mes bashkësive të ndryshme etnike në nivel lokal, duke kontribuar për paqe dhe evropianizim të rajonit. Po ashtu përpiqen që

të kontribuojnë në ngritjen e kompetencave politike të popullsisë lokale dhe të komuniteteve, si dhe të përfaqësuesve të tyre politikë.

Kontakti: misa.stanojkovic@yahoo.com

Mendimet dhe qëndrimet e shprehura në këtë dokument janë pikëpamje personale të autorëve, dhe nuk i paraqesin domosdo pikëpamjet e Fondacionit-Konrad-Adenauer.

Kontakti:

Konrad-Adenauer-Stiftung

Zyra në Kosovë

Bulevardi Nëna Terezë 30-3/6

KO-10000 Prishtinë

Telefoni +381 (0) 38 229 874

Prishtina@kas.de

www.kas.de/kosovo